



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1132/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Milena Đerić dhe Adnan Konushevci anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, për shkak të Thyerjes së Heshtjës Zgjedhor, për Raundin e dytë, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura me datë 14.11.2021, për në seancën e panelit të mbajtur më datë 15.11.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**Pranohet** e bazuar ankesa Anr.1132/2021 të datës 14.11.2021, e paraqitur nga subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, ndërsa subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës me seli në Prishtinë, i **SHQIPTOHET** gjobë në vlerë prej 2,100.00 € (dy mijë e njëqind euro,) për shkak të Thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura me datë 14.11.2021.

**II. DETYROHET** Subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së këtij vendimi, nën kërcënim e shqiptimit të dënimit shtesë.

## A r s y e t i m

PZAP-i me datën 14.11.2021, ka pranuar një ankesë nga subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se me datë 14 nëntor 2021, rreth orës 09:30, aktivist e Lëvizjes Vetëvendosje, nga qendra në Viti, kanë vërejtur se nënkryetari i Komunës së Vitisë, Hasan Aliu nga selia e kësaj partie ka mbajtur konferencë shtypi, te cilën e ka transmetuar Plus Tekevizioni. Me këtë rastë ka thyer heshtjen zgjedhore të sanksionuar me nenin 36 par.1 pika b) të LZP-së. Ankesës i ka bashkangjitur si provë video konferencën për media të datës 14.11.2021.

PZAP, me datë 14.11.2021, i ka dërguar subjektit politik kërkesë për përgjigje, me afat kohorë deri me datë 15.11.2021, në ora 10:00.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me të cilën e pranon se një veprim i tillë nga nënkryetari Komunës së Vitisë, Hasan Aliu, konsiderohet shkelje e nenit 36 par.1, pika b) të LZP-së.

**Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:**

#### **Ankesa është e bazuar**

Nga shkresat e lëndës shihet qartë se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës konkretisht nënkryetari i Komunës së Vitisë, Hasan Aliu nga selia e kësaj partie ka mbajtur konferencë shtypi, te cilën e ka transmetuar Plus Tekevizioni, në të cilën konferencë mbrapa tij ka shfaqur logon e këtij subjekti, sloganin e partisë, “Vitia për të Gjithë”, si dhe emrin e kandidatit për Kryetar të Komunës së Vitisë, e që me këtë veprim ka bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Pasi që paneli, bëri vlerësimin e pretendimeve të palëve në procedurë, vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave së bashku, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 117 par. 2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), nga të njëjtat vërtetoi faktin e pretenduar si në parashtrimet e ankesës se nënkryetari i Komunës së Vitisë, Hasan Aliu nga selia e kësaj partie ka mbajtur konferencë shtypi, te cilën e ka transmetuar Plus Tekevizioni, në të cilën konferencë mbrapa tij ka shfaqur logon e këtij subjekti, sloganin e partisë, “Vitia për të Gjithë”, si dhe emrin e kandidatit për Kryetar të Komunës së Vitisë.

Andaj Paneli, duke iu referuar të cekurave më lart dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, është përgjegjëse për veprimet e tija, pasi që me veprimet e lartcekura ka shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së, që përcakton se: *“veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku thuhet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”*.

Paneli, me rastin e shqiptimit të gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, u mbështet në dispozitat e lartcekura, e në veçanti duke marr parasysh rrethanat e rastit siç janë: natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj, në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, pozitën e shkelësit (nënkryetar) faktin se subjekti politik të cilit i është shqiptuar gjoba, ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, shumë e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore. Gjithashtu paneli pati parasysh edhe pohimin në përgjigje në ankesë që ka bërë subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me të cilën ka pranuar se veprimet e nënkryetarit të këtij subjekti përbëjnë shkelje të nenit 36 pika b) të LZP-së..

Paneli, vlerëson se gjoba e shqiptuar si masë, përveç aspektit të dënimit në raport me subjektin që nuk e ka respektuar Kodin e Mirësjelljes, shërben edhe si masë preventive që në të ardhmen subjektet politike të përmbahen nga veprimet e tilla që bien ndesh me rregullativën ligjore, që cenojnë të drejtën apo lirinë e votimit, në mënyrë që të sigurohet klimë e qetë dhe e përshtatshme për votim të lirë dhe të pa ndikuar si bazament i një procesi demokratik zgjedhor.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do të shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: “ 120.2 Dështimi për të paguar dënimin apo për t’ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i. ”, ashtu siç është vendosur në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli mbi bazën e të dhënave të lartcekuar në mbështetje të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 1132 më datën 15.11.2021

**Kryesuesi i Panelit**  
**Ferki Xhaferi**



***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.***